UDHËZIM
Nr.1, datë 30.1.2006

PËR SISTEMIN E TAKSAVE KOMBETARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ministria e Financave nxjerr këtë:

UDHËZIM:

1.Dispozita të përgjithshme

1.1. Në zbatim të nenit 7 të ligjit Nr.8977, datë 12.12.2002, taksat kombëtare derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit. Taksat vjetore, me përjashtim të taksës vjetore të qarkullimit rrugor, arkëtohen nga agjentët e taksave brënda tremujorit të parë të vitit në vazhdim. Kur detyrimi lind në 6-mujorin e parë te vitit, taksat paguhen në masën 100%, ndërsa kur detyrimi lind për herë të parë në 6-mujorin e dytë, taksat paguhen në masën 50 për qind të shumës së taksës vjetore të përcaktuar në ligj.

1.2. Në zbatim të nenit 6 të ligjit agjentët e taksave janë të detyruar të bëjnë vjeljen e taksave dhe të derdhin në buxhet shumat e vjela sipas ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

1.3. Në zbatim të nenit 9, agjentët e taksave të përcaktuar në nenin 6 të ligjit, përfitojnë një përqindje të caktuar të arkëtimeve nga taksat. Punonjësit e taksave në degët e tatimeve në rrethe bëjnë aktrakordime me agjentët e taksave për taksat e vjela, si dhe përcaktojnë shumën që u takon agjentëve të taksave. Aktin e rakordimit, i cili do të jetë i firmosur nga inspektori i taksave, përfaqësuesi i agjentit të taksave, si dhe nga kryetari i Degës së Tatimeve, agjentët e taksave duhet ta paraqesin në degën e thesarit të rrethit ku ushtrojnë aktivitetin e vjeljes së taksave. Modeli i aktit të rakordimit dhe përmbajtja e tij do të jetë sipas formularit nr.1 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Kriteret e përdorimit të komisioneve që ju jepen agjentëve të taksave janë përcaktuar në ligj dhe përdoren:

- për shpërblimin e punonjësve që merren me vjeljen e taksave. Drejtuesi i agjentit të taksave cakton punonjësit që merren me vjeljen e taksave. Këta punonjës përgjigjen për vjeljen dhe arkëtimin e taksave sipas ligjit;
- për përballimin e shpenzimeve të vjeljes së taksave si prodhim pulla takse, shtypshkrime, komisione bankare etj.).

2.Dispozita të veçanta

Sipas llojit të taksave, kemi :

2.1. Taksat portuale.

Ngarkohen me vjeljen e këtyre taksave kapiteneria e porteve, e cila i vjel këto taksa drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjencive detare shtetërore ose private. Taksat portuale paguhen nga anijet shqiptare ose të huaja sa herë prekin portet e Republikës së Shqipërisë në bazë të nivelit të taksave të përcaktuara në lidhjen nr.1 të ligjit "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë". Taksat portuale paguhen me mbërritjen e anijes dhe janë të vlefshme për të gjithë kohën që anija qëndron në port.

Në kuptimin e pikës 6 të lidhjes nr.1, nëse anija për kryerjen e veprimeve të saj do të prekë edhe një port tjetër shqiptar, paguan vetëm në portin e parë. Pra, nëse një anije mbërrin në Durrës dhe shkarkon një pjesë të mallit dhe në të njëjtin rejs shkarkon pjesën tjetër në Shëngjin atëherë kjo anije paguan vetëm në portin e parë. Në qoftë se një anije që vjen nga një port i huaj shkarkon në portin e Durrësit ku paguan taksat portuale dhe ngarkon në këtë port një mall të ri të cilin e shkarkon në një port tjetër shqiptar si p.sh. në Vlorë, atëhere kjo anije do të paguajë taksat portuale edhe në portin e Vlorës.

Taksat portuale paguhen në secilin port të Shqipërisë pavaresisht nëse anija mbërrin nga jashtë ose nga një port tjetër i shtetit shqiptar. Pagesat e taksave nga anijet e huaja bëhen në euro sipas lidhjes nr.1 të ligjit. Në zbatim të pikës 5 të kësaj lidhje taksat portuale mund të paguhen edhe në valuta të tjera lirisht të konvertueshme me kursin ditor të këmbimit. Për anijet e personave juridike apo fizike shqiptare shtetëror apo privat taksat llogariten dhe paguhen në lekë apo valutë, duke e konvertuar me kursin ditor të këmbimit në bankë. Anije të subjekteve shqiptare do të konsiderohen anijet që janë në

pronësi të vet dhe anijet e marra me qera. Të gjitha përjashtimet nga pagesat e taksave portuale të parashikuara në këtë ligj do të regjistrohen në nje regjistër të veçantë sipas formularit nr.8 bashkëngjitur këtij udhëzimi.

2.2. Taksat për shërbimet konsullore

Taksat për shërbimet konsullore vilen nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme dhe institucionet e tjera në varësi të tyre sipas përcaktimeve të bëra në ligj.

Shtetasit që pajisen me pasaportë për dalje jashtë shtetit, përveç pagimit të vlerës së pasaportës do të paguajnë dhe taksën të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të lidhjes nr.2 "Taksat për shërbimet konsullore".

Për shërbimet që kryhen nga përfaqësitë tona diplomatike në vende të tjera, në bazë të lidhjes nr.2 "Për taksat për shërbimet konsullore" niveli i taksës përcaktohet në euro dhe pagimi i tyre mund të bëhet në euro, në dollarë ose në monedhën e vendit ku kryhet shërbimi, konvertuar me kursin përkatës ditor të këmbimit.

Ministria e Punëve së Jashtme çdo muaj derdh në degën e thesarit Tiranë shumën e taksave konsullore të arkëtuara nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë shtetit. Dega e thesarit pasi bën rakordimet e nevojshme me Ministrinë e Jashtme, brenda ditës së fundit të muajit, shumën e taksave konsullore e kalon në llogarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Me termin përfaqësi kuptohet përfaqësia diplomatike apo konsullore e Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Taksat për veprimet konsullore arkëtohen me fillimin e procedurës përkatëse. Institucionet shtetërore që do të presin shtetas të huaj, të cilët sipas nenit 10 të ligjit janë të përjashtuar nga pagesa e taksës së vizës ose të hyrjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, i konfirmojnë pikave të kalimit të kufirit, emrat e personave të cilët janë të përjashtuar. Konfirmimi për këtë qëllim jepet vetëm nga titullari i institucionit shtetëror.

Ministria e Jashtme i dërgon Ministrisë së Brendshme, listën e taksës së vizës dhe të hyrjes. Ministria e Brenshme dërgon në PKPK listën e taksës së vizës dhe të hyrjes.

Taksa e hyrjes ose taksa e vizës paguhet në euro, ose valutë tjetër lirisht të konvertueshme. Me vjeljen e taksës së hyrjes në territorin e Republikes së Shqipërisë ngarkohen PKPK. Me vjeljen e taksës së vizës ngarkohen edhe përfaqësitë. Në rastet kur viza jepet në kufi taksa e vizës arkëtohet nga PKPK mbi bazën e konfirmimit nga dega e vizave në Ministrinë e Brendshme. Vjelja e taksës së hyrjes ose të vizës në PKPK dokumentohet me mandatarkëtimi, i cili duhet të përmbajë veç shënimeve standarde, edhe shtetësinë e paguesit, numrin rendor të regjistrit të hyrjes të shtetasve të huaj, llojin e monedhës që derdh i huaji. Mandati i arkëtimit përpilohet nga kontrolli i shërbimit të PKPK, në dy kopje, njëra nga të cilat i jepet qytetarit të huaj dhe tjetra mbahet nga PKPK.

Përjashtimisht për pikën e kontrollit të kalimit kufitar Rinas në zbatim të Marrëveshjes së Koncesionit ngarkohet Tirana Airport Partnes për vjeljen e taksës së hyrjes apo të vizës për shtetasit e huaj. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme, japin zyrtarisht nivelin e taksave të hyrjes apo të vizës për çdo shtet.

Të ardhurat e realizuara nga vjelja e taksave derdhen çdo 5 ditë në llogarinë e degës së tatimeve.

Në zbatim të nenit 8, shkronja a, për vjeljen e taksave konsullore me anën e pullës, Ministria e Jashtme planifikon dhe porosit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve pullat konsullore për nevojat e saj dhe të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit.

2.3. Taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve

Taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve i nënshtrohen të gjitha mjetet e klasifikuara sipas lidhjes nr.10 të ligjit, që janë të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Kjo taksë arkëtohet nga Qendrat e Kontrollit Teknik të Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Pagesa e taksës bëhet në çdo kohë, por gjithnjë para kryerjes së kontrollit teknik të mjetit. Vlera e taksës është vjetore pavarësisht nga momenti në të cilin ajo paguhet. Edhe mjetet e reja, pavarësisht nga momenti i targimit të tyre, paguajnë vlerën e plotë të taksës. Pagesa e kësaj takse shoqërohet me faturë, me pullën e taksës, si dhe biletën me numër serial në të cilën përveç të dhënave të mjetit shënohet edhe vlera e taksës së paguar. Zotëruesi i mjetit e vendos pullën e taksës në xhamin e përparmë të mjetit për të lehtësuar ushtrimin e kontrollit vizual nga organet e Ministrisë së Brendshme dhe Policia Tatimore. Këto dokumente prodhohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe shpenzimet përballohen nga ky institucion në zbatim të nenit 9

pika 3 të ligjit. Dokumentet e mësipërme duhet të përmbajnë elemente të sigurisë së lartë, për të shmangur falsifikimin e tyre.

Drejtoritë Rajonale të Transportit rrugor bëjnë regjistrimin ditor të arkëtimit të taksës që shërben si dokument bazë për rakordimin e pagesës së taksës me degët e tatimeve. Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë forma dhe përmbajtja e të cilit jane sipas formularit nr.2 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Këto drejtori, brenda datës 31 janar të çdo viti, dërgojnë në degët përkatëse të tatimeve listën e mjeteve të regjistruara, duke shënuar edhe datën e fundit të kontrollit teknik të mjetit.

Drejtoritë Rajonale, deri në datën 15 të muajit pasardhës, evidentojnë dhe dërgojnë në degët përkatëse të tatimeve dhe në organet e Ministrisë së Brendshme listën e mjeteve që nuk janë paraqitur për të bërë kontrollin teknik dhe që për rrjedhojë nuk kanë paguar taksën.

2.4. Taksa e qarkullimit të automjeteve të huaja.

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen degët e doganave në pikat e kalimit kufitar. Personat në momentin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë me automjete me targë të huaj, pajisen nga degët e doganave me një vërtetim hyrje sipas formularit nr.3 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ky vërtetim mbahet në dy kopje, nga të cilat njëra i jepet personit që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me automjet me targë të huaj, ndërsa kopja tjetër ruhet në degët e doganave. Ky vërtetim është i detyrueshëm të paraqitet në degën e doganës në pikën e kalimit kufitar në dalje, me qëllim që degët e doganave të llogarisin dhe arkëtojnë taksën e qarkullimit të automjetit me targë të huaj dhe të arkëtojnë taksën për ditët e qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo pagesë bëhet me mandat arkëtimi, një kopje e të cilit i jepet personit, ndersa kopja tjetër i bashkëngjitet vërtetimit që personi paraqet në dalje dhe ruhet në degën e doganës.

Për rastet kur automjeti me targë të huaj, me akt noterial, kalon në pronësi të personave të tjerë dhe pajiset me targë shqiptare, pronari i paraqet degës së doganës në momentin e zhdoganimit të automjetit vërtetimin e hyrjes që i është dhënë personit në pikën e kontrollit të kalimit kufitar në hyrje, me qëllim që të llogaritet edhe taksa e qarkullimit të automjetit për ditët e qëndrimit në Shqipëri. Drejtoritë rajonale të transportit rrugor nuk bëjnë pajisjen me targa shqiptare si dhe regjistrimin e mjetit pa u paguar detyrimet e taksës së qarkullimit të automjeteve të huaja.

Shumat e taksave të arkëtuara në degët e doganave regjistrohen në një regjistër të veçantë sipas formularit nr.4 bashkëngjitur këtij udhëzimi, ku shënohet lloji i mjetit, ditët e qëndrimit, si dhe shuma e taksës së paguar.

Në zbatim të nenit 10 të ligjit, përfituesit e përjashtimeve nga pagimi i kësaj takse paraqesin pranë degës përkatëse të tatimeve një kërkesë ku përcaktohet automjeti me targë të huaj, tipi, numri i shasisë dhe targa përkatëse. Dega e tatimeve i lëshon kërkuesit një shkresë nëpërmjet të cilës miraton përjashtimin. Me paraqitjen e kësaj shkrese të lëshuar nga dega e tatimeve, dega e doganës në hyrje lëshon një vërtetim sipas formularit nr. 5 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ky vërtetim është në dy kopje, një prej të cilave i jepet zotëruesit të mjetit, ndërsa kopja tjetër ruhet në degën e doganës. Në dalje të mjetit me targë të huaj nga territori i Republikës së Shqipërisë, dega e doganës detyron zotëruesin e mjetit të dorëzojë kopjen e vërtetimit.

Nga zbatimi i këtij rregulli përjashtohen automjetet e rregjistruara në territorin e Kosovës të cilat, në zbatim të pikës (d) të nenit 10 të ligjit të sipërpërmendur e përfitojnë përjashtimin automatikisht (pra pa plotësuar procedurat e mësipërme).

2.5. Taksa e importimit të automjeteve të përdorura.

Agjent tatimor për vjeljen e taksës së importimit të automjeteve të përdorura janë degët e doganës në pikat e kalimit të kufirit. Kjo taksë paguhet nga importuesi i automjetit në momentin e zhdoganimit të tij. Degët e doganës bëjnë llogaritjen e taksës së importimit të automjeteve të përdorura sipas llojeve të mjeteve:

2.5.1. Për autoveturat

Llogaritja e taksës bëhet sipas formulës:

Taksa fikse x Cilindrata e motorit x koeficienti i viteve të përdorimit. Taksa fikse për autoveturat me naftë është 25 mijë lekë, ndërsa për autoveturat me benzinë 20 mijë lekë. Cilindrata e motorit është volumi i dhomës së djegjes së motorrit të shprehur në centimetër kub dhe është dhënë në cetifikatën shoqëruese të mjetit.

Vite përdorimi quhet diferenca ndërmjet vitit kur mjeti hyn në doganën shqiptare dhe vitit të prodhimit.

Shembull: Llogaritja e taksës për një autoveturë tip benz 190 i prodhuar në vitin 2000 me

naftë dhe i importuar ne vitin 2005, behet si me poshte:

Koeficienti sipas ligjit është 0.0018

Cilindrata e motorit është 1930 centimetër kub

Taksa fikse 25 mije leke.

1930 x 25000 x 0.0018 = 86.9 mijë lekë

Shembull: Llogaritja e takses për një autoveturë e cila në momentin e zhdoganimit ka mbi 10 vjet prodhimi, per të njëjtin tip autoveture si ne shembullin e mesiperm, behet si me poshte :

1930 x 25000 x 0.003 = 144.8 mije leke

2.5.2. Për mjetet e tjera të transportit

Llogaritja e takses është e diferencuar sipas vitit të prodhimit :

prodhuar deri në 31 dhjetor 1995, dhe

prodhuar nga 1 janari 1996

Taksa është fikse sipas llojit të mjetit e përcaktuar në pikën 5 të nenit 5 të ligjit. Degët e doganës të gjitha arkëtimet nga taksat i evidentojnë në regjister, sipas formularit nr.6 bashkengjitur ketij udhezimi.

2.6. Taksa e pajisjes me leje drejtimi për drejtim automjeti.

Taksa për pajisjen me leje drejtimi për drejtim automjeti arkëtohet nga drejtorite rajonale të transportit rrugor. Detyrimi i pagimit të kësaj takse lind në momentin e dhënies së dëshmisë se aftësisë për drejtim automjeti. Shtetasi duhet të pajiset me dokumentin që vërteton pagimin e kësaj takse. Të gjitha pagesat e taksës do të regjistrohen në një regjistër të veçantë sipas formularit nr.7 bashkëngjitur udhëzimit.

2.7. Taksa e përdorimit të aparateve radio-televizive.

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen zyrat e pagesës së energjisë elektrike dhe vjelja e kësaj takse duhet të bëhet brenda tremujorit të parë. Kjo taksë paguhet për marrësit radiofonikë dhe televizivë individuale që janë në gjëndje teknike të marrin programe të radios ose të televizionit. Për çdo familje merret në konsiderate vetëm një marrës i çdo lloji. Kur familjet kanë vetëm marrës radio ato paguajnë vetëm taksën për radion. Për këtë ata duhet të njoftojnë në degën e tatimeve të rrethit ku banojnë, e cila verifikon nëse ka vetëm aparat televiziv dhe i jep vërtetimin me firmën e kryetarit të degës. Kur familja ka vetëm marrës televiziv do të ndiqet e njëjta procedure si në rastin e marësit radiofonik.

Personat fizikë e juridikë paguajnë taksën për përdorimin e aparaturave radiotelevizive për të gjitha aparaturat që disponojnë në ambientet e tyre.

Degët e tatimeve bashkëpunojnë me zyrat e pagesës së energjisë elektrike për njoftimin dhe pagimin nga ana e zoteruesve te taksës së aparateve radiotelevizivë. Pagesat e taksës vërtetohen për përdoruesit në librezën e pagesës së energjisë elektrike ku shënohet "taksa e paguar për vitin ____, data e pagesës si dhe firma dhe vula e punonjësit të ngarkuar me vjeljen e kësaj takse.

2.8. Taksa e përdorimit të numrit telefonik

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen operatorët përkatës të numrit telefonik dhe paguhet brenda tremujorit të parë të çdo viti. Pagesa e kryer vërtetohet në librezën e pagesës së telefonit për telefonat kabllore, ku shënohet "taksa e telefonit e paguar për vitin ____ si dhe firma e punonjësit të ngarkuar për vjeljen e kësaj takse dhe vula. Për telefoninë celulare pagesa e taksave të zotëruesve të aparateve celulare bëhet nga operatorët celulare, te cilët janë përgjegjes për vjeljen e taksave. Degët e tatimeve bëjnë çdo muaj rakordimet për numrat celulare të shitur si dhe kontrollin e derdhjes së taksave .

2.9. Taksa për veprime e shërbime nga administrata gjyqësore, Ministria e Drejtësisë, prokuroria, noteritë dhe zyrat e regjistrimit të pasurive te paluajtshme.

Me vjeljen e këtyre taksave ngarkohen Ministria e Drejtësisë, organet gjyqësore, prokuroria, zyrat e noterisë dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Këto taksa paguhen në momentin e kryerjes së veprimeve sipas lidhjes nr.5 të ligjit dhe bëhen me anën e pullës për taksat fikse ose me mandat arkëtim për ato raste kur, në bazë të ligjit, kjo taksë është shprehur në përqindje. Pullat e taksave vendosen në çdo kopje të dokumentit të lëshuar, për të gjitha dokumentet që sipas ligjit duhet të pajisen me pulla takse. Dokumentet janë të vlefshme kur pulla e taksës është e vulosur nga organi që kryen shërbimin. Për plotësimin e vlerës së pullës për aktet që lëshohen mund të përdoren një ose më shumë pulla, me kusht që ato të plotesojne vlerën e taksës. Në rast se personi kërkon kopje të akteve apo dokumentave të lëshuara nga organet gjyqësore apo noteriale, vlera e pullës së taksës është përcaktuar në lidhjen Nr. 5 të ligjit, me kusht që tek akti ose dokumenti të jetë shënuar fjala "kopje".

Në rast të kundërt merret vlera e plotë e taksës. Taksa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve gjyqësore apo noteriale.

Në zbatim të nenit 9 pika 9/a, organet e mësipërme, me përjashtim të zyrave të noterisë të cilat nuk përfitojnë komision, përfitojnë si agjentë taksash një komision 2%. Në po këtë nen pika (c), përcaktohet që personat e autorizuar nga ligji nr.8002, datë 27.9.1995 "Për përdorimin dhe administrimin e pullave të taksave", për shitjen e pullave të taksës përfitojnë komisioni 3 për qind. Në rast se organet e mësipërme kryejnë rolin e agjentit për të dy rastet, atëherë do të përfitojnë 2% komision për rastin e pare dhe 3% komision për rastin e dytë.

2.10. Taksa e regjistrimit në arsimin e lartë.

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen universitetet dhe shkollat e tjera të larta. Këto taksa arkëtohen jo më vonë se 30 ditë nga data zyrtare e fillimit të vitit të ri shkollor, për çdo vit arsimor. Pagesat e taksave regjistrohen në regjistër dhe derdhen në llogarinë e degës së tatimeve jo më vonë se 5 ditë nga data e arkëtimit.

2.11. Taksa për shërbimet e radiokomunikacioneve.

Me vjeljen e këtyre taksave ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve (ERT). Llogaritjet teknike të taksave bëhen nga ERT sipas lidhjes nr.6. ERT nuk u jep licencë subjekteve fizike apo juridike për përdorimin e sistemeve të radiokomunikimit pa vjelë taksat. ERT njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për rastet kur subjektet nuk rinovojnë licencat si dhe në rastet e identifikimit të përdorimit abuziv të spektrit të frekuencave. Taksa për shërbimet e radiokomunikacioneve është takse vjetore dhe arkëtohet deri ne diten e fundit te tremujorit të pare të vitit. Brenda dates 15 Prill të çdo viti Enti Rregullator i Telekomunikacioneve bën akt-rakordimin përfundimtar me degën e tatimeve.

2.12.Taksa vjetore për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit (KKRT). Llogaritjet teknike të taksës bëhen nga KKRT sipas lidhjes nr.9 te ligjit. KKRT njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kur subjektet nuk paguajnë taksën vjetore të sherbimeve te tramsmetimeve radiotelevizive, kur nuk rinovojnë liçensat si dhe në rastet e identifikimit të transmetimeve të paliçensuara. Të gjitha këto taksa arkëtohen çdo 5 dite në Buxhetin e Shtetit.

2.13. Taksa e kalimit me avion te kufirit shtetëror

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohet Tirana Aeroport Partners (TAP). Kjo taksë paguhet në momentin e blerjes së biletës nga udhëtari. TAP, në zbatim të ligjit, Marrëveshjes së Koncesionit dhe këtij udhëzimi, kryen të gjitha procedurat për regjistrimin e kësaj takse në sistemin e IATA-s. Pas këtij regjistrimi, çdo shoqëri ajrore në momentin e shitjes së biletave duhet t'i shtojë vlerës së biletës, si dhe ta pasqyrojë në të, edhe vlerën e kësaj takse. Vjelja e taksës kryhet pavarësisht vendit të shitjes apo mënyrës së shitjes së biletës nga shoqëritë ajrore. Vjelja e taksës së paguar nga udhëtarët në momentin që ata blejnë biletën e avionit dhe që derdhet nga ana e shoqërive ajrore duhet të reflektohet nëpërmjet faturimeve që TAP i lëshon shoqërive ajrore që operojnë në aeroportin Nënë Tereza. Faturimet përpunohen mbi bazën e dokumentit të udhëtimit të pasagjerëve dhe këto dokumente ruhen në TAP dhe shoqërinë ajrore. Shumat e arkëtuara nga TAP, nëpërmjet shoqërive ajrore, derdhen brenda 5 dite-pune në llogarinë e degës së tatimeve.

Të gjithë personat që në bazë të ligjit përjashtohen nga pagimi i taksës së kalimit të kufirit me avion, do te paguajnë këtë taksë në momentin e prerjes së biletës së udhëtimit dhe më pas vlera e taksës së paguar do të rimbursohet nga degët e tatimeve mbi bazen e dokumenteve që vërtetojnë përjashtimin nga taksa.

Çdo muaj do të bëhet rakordimi i taksës se mbledhur nga TAP-i me PKPK Rinas dhe Shoqëritë ajrore.

Kjo pike e këtij udhëzimi, hyn në fuqi më datë 1 mars 2006. Mbledhja e kësaj takse për periudhën tranzitore, deri në kete date do të vazhdoje te bëhet nga dega e doganes Rinas sipas procedurave ne fuqi.

2.14. Taksa e pajisjes se personave me pasaportë lundrimi

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohet Kapiteneria e Porteve. Pasaporta e lundrimit është dokument identifikimi i pjesëtarëve të ekuipazheve të anijes ose personave të tjerë që mund të punojnë dhe udhëtojnë me këto anije. Kjo taksë derdhet brenda 5 ditësh nga momenti i arketimit ne llogarinë e degës së tatimeve. Modeli i pasaportës dhe procedurat e dhënies së saj përcaktohen nga Ministria e

Transporteve.

2.15. Taksa për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit

Kjo taksë është vjetore dhe me vjeljen e saj ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme e Peshkimit. Pagesat e kesaj takse behen sipas lidhjes nr.7 të ligjit. Detyrimi për pagimin e kësaj takse lind në momentin e marrjes së lejes për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit. Lejet për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit jepen mbasi të jetë paguar taksa përkatëse. Kjo taksë derdhet ne llogarinë e degës së tatimeve brenda 5 ditesh nga momentimi i arketimit.

2.16. Taksa e akteve dhe e pullës

Vjelja e këtyre taksave bëhet nga zyrat e gjëndjes civile. Shtetasit për çdo dokument të lëshuar nga zyrat e gjendjes civile janë të detyruar të paguajnë taksën sipas lidhjes nr.5 të ligjit. Dokumentet e gjendjes civile janë të vlefshme vetëm kur kanë pullën e taksës të vulosur me vulën e gjëndjes civile. Shtetasit shqiptarë që pajisen me pasaportë për brënda vëndit (karten e identitetit) paguajnë përveç vlerës së pasaportës edhe taksën perkatese prej 100 leke te percaktuar në lidhjen nr.5. Vjelja e kësaj takse bëhet me mandat arkëtimi. Derdhja e taksave të vjelura në llogarinë e organit tatimor do të bëhet jo më vonë se 5 ditë nga data e arkëtimit.

2.17. Taksa e rentës minerare

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen degët e tatimeve. Leja për shfrytëzimin e pasurisë minerare jepet nga Ministria e Industrise dhe Energjitikes. Zotëruesi i lejes regjistrohet në organet tatimore dhe brenda datës 15 të muajit pasardhës duhet të derdhë për llogari të degës së tatimeve ku ushtron aktivitetin e tij taksën e rentës së pasurisë të specifikuar në nenet 51, 74 dhe 83 të ligjit minerar, sipas vlerës së tregut të mineraleve të shitura konsumatorëve gjatë muajit. Për të përcaktuar vlerën e tregut të këtyre mineraleve me qëllim që të llogaritet renta e pasurisë minerare veprohet si vijon:

1. Vlera e tregut të mineralit të shitur tek konsumatori gjatë muajit kalendarik jepet:

a. Në rastin kur produkti i shitur është mineral i nxjerrë nga miniera, vlera e tregut të mineralit është e barabarte me çmimin e shitjes së produktit.

b. Në rastin kur produkti përfundimtar i shitur është përpunuar më tej, vlera e tregut të mineralit është e barabartë me çmimin e shitjes së produktit përfundimtar gjatë muajit kalendarik minus:

- Shpenzimet e pasurimit, shkrirjes dhe të rafinimit që janë kryer mbi mineralin.
- Shpenzimet e transportit nga miniera në fabrikën e pasurimit, shkritore ose impiantet e rafinimit të mineralit.
- Të gjitha shpenzimet e tjera të cilat nuk janë zbritur në pikën 1 dhe që lidhen me koston e pasurimit, shkrirjes ose rafinimit.

2. Çmimi i shitjes nënkupton:

a. N.q.s. produkti eksportohet çmimi i shitjes është F.O.B. Shqipëri.

b. N.q.s produkti nuk eksportohet çmimi i shitjes është i barabartë me çmimin e shitjes brenda vendit minus:

- Shpenzimet e transportit të produktit nga pika e prodhimit deri në pikën e shitjes F.O.B Shqipëri
- Shpenzimet e tjera të shitjes nëse ka të tilla.

Zotëruesi i lejes, dorëzon brenda datës 5 të çdo muaji formularin tip nr.9 bashkengjitur ketij udhezimi. Ai duhet te jape gjithashtu kur eshte e nevojshme edhe të dhënat e mëposhtme:

a. Emrin dhe përshkrimin e mineralit

b. Emrin dhe adresën e zotëruesit të lejes dhe administratorit

c. Sasinë e mineralit të prodhuar gjatë muajit të kaluar

d. Një konfirmim lidhur me prodhimin e muajit të kaluar dhe shpërndarjen e tij (psh. tek konsumatorët, fabrikat e pasurimit, shkritoret, rafineritë ose të depozituar)

e. Sasinë e mineralit të shitur tek konsumatorët gjatë muajit kalendarik, emrat dhe adresat e blerësve dhe kontratat e shitjes të cilat duhet të përmbajnë veçoritë mbi natyrën, cilësinë dhe përmbajtjen e mineraleve.

f. Emrat dhe vendndodhjet e fabrikave të pasurimit, shkritoreve dhe rafinerive ku është shpërndarë minerali.

g. Koston për ton të fabrikës së pasurimit, shkritoreve, dhe rafinerive ku është shpërndarë

minerali gjatë muajit kalendarik.

h. Koston për ton të transportit të mineralit të shitur gjatë muajit kalendarik e detajuar kjo në rastin kur transporti i mineralit kryhet duke kaluar në disa hallka transporti

i. Shpenzimet e shitjes nëse ka dhe që janë kryer gjatë muajit kalendarik

j. Një llogaritje të detajuar të rentës së pasurisë minerare gjatë muajit kalenderik.

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit duhet të mbajë pranë minierës librat përkatës të prodhimit të mineralit nga zona e lejuar dhe të gjithë dokumetacionin që lidhet me to. Të gjitha të dhënat mbi prodhimin, transportin përpunimin dhe shitjen, përfshirë këtu dhe kontratat e shitjes kontrollohen nga degët e tatimeve dhe taksave.

2.18. Taksa e kalimit te se drejtës së pronesise per pasurite e luajtshme (automjetet)

Per taksen e kalimit te se drejtes se pronesise te pasurive se luajtshme (automjetet) ngarkohen Drejtorite Rajonale te Transportit Rrugor. Kjo takse aplikohet per çdo ndryshim te pronesise se mjeteve. Taksa e kalimit te pronesise vilet ne momentin kur dokumenti i kalimit te pronesise (me aktin noterial te shitjes, dhurimit e te tjera te ngjashme me to) paraqitet per veprim ne Drejtorite Rajonale te Transportit Rrugor per pajisjen me lejen e re te qarkullimit te mjetit. Pronari i ri, perveç dokumentacionit që nevojitet për të legalizuar kalimin e të drejtës se pronesisë, paraqet edhe një kopje te noterizuar te kontrates se kalimit te se drejtes se pronesise. Te gjithe pronaret e mjeteve qe bejne kalim te pronesise se mjetit, paguajne taksen e kalimit te pronesise ne masën 2% te vleres se kalimit te pronesise te shprehur ne kontrate por jo më pak se çmimi dysheme i përcaktuar në Ligj, i cili merr për baze edhe vitin e prodhimit. Drejtorite Rajonale derdhin taksat e vjela për llogari të organit tatimor jo më vonë se 5 ditë nga data e arkëtimit.

2.19. Taksa e karbonit per benzinen, benzolin dhe gazoilin

Taksa e karbonit eshte caktuar ne masen 0.5 leke per liter per benzinen dhe benzolin dhe 1 leke per liter per gazoilin. Per benzinen, benzolin dhe gazoilin e importuar vjelja e taksës së karbonit bëhet nga deget e doganave. Kjo taksë paguhet në momentin e deklarimit në doganë te benzines, benzolit apo gazoilit të importuar.

Taksa e karbonit per benzinen, benzolin dhe per gazoilin e importuar nuk perfshihet në bazen e taksueshme per efekt te llogaritjes se takses doganore, TVSH-se dhe akcizes.

Taksat e karbonit per benzinen, benzolin dhe gazoilin e importuar, për mallrat qe vendosen ne regjimin e pezullimit tatimor ose doganor, nuk aplikohet në momentin e vendosjes në këto rregjime, por ne momentin kur mallrat çlirohen nga këto regjime.

Per gazoilin, benzinen dhe benzolin e prodhuar ne vend, prodhuesit deklarojnë dhe paguajnë taksën e karbonit në degën përkatëse të tatimeve në momentin e levizjes se ketyre produkteve nga vendi i prodhimit.

Shumat e arketuara nga kjo takse derdhen cdo 5 dite ne llogarine e deges perkatese te tatimeve.

2.20. Taksa per ambalazhet plastike të lengjeve

Taksa e ambalazheve plastike te lengjeve te importuar apo te prodhuar ne vend llogaritet ne masen 2 leke per cope per ambalazhet e lengjeve me kapacitet mbi 1.5 litra dhe 1 lek per cope per ambalazhet me kapacitet te barabarte ose me te vogel se 1.5 litra. Per mallrat e importuara kjo takse arketohet nga Drejtoria Pergjithshme e Doganave nepermjet Degeve te saj, në momentin e çdoganimit të mallit.

Taksat e ambalazheve plastike te lengjeve nuk perfshihen ne bazen e taksueshme per efekt te llogaritjes te takses doganore, TVSH-se dhe akcizes.

Taksa për ambalazhet plastike të lengjeve per mallrat qe vendosen ne regjimin e pezullimit tatimor ose doganor nuk aplikohet në momentin e vendosjes në këto rregjime, por ne momentin kur mallrat çlirohen nga këto regjime.

Për ambalazhet plastike bosh te lengjeve, te cilat importohen, taksa nuk llogaritet ne momentin e cdoganimit te mallit, por tek prodhuesi i lengjeve.

Per mallrat me ambalazhe plastike te prodhuara ne vend, vjelja e taksës behet nga deget e tatimeve, në momentin e shitjes së mallrave. Prodhuesit e lengjeve me ambalazhe plastike bejne llogaritjen e takses te cilen me pas e derdhin ne llogarine e deges perkatese te tatimeve. Brenda dates 14 te çdo muaji subjektet dorezojne ne degen e tatimeve formularin e deklarimit sipas modelit nr. 10 bashkengjitur ketij udhezimi

2.21. Taksa per regjistrimin e lojërave te fatit, kazinote dhe per garat sportive qe zhvillohen ne hipodrom

Taksa per regjistrimin e lojrave te fatit, kazinote dhe per garat sportive qe zhvillohen ne hipodrom paguhet vetem njehere ne momentin e fillimit e veprimtarise dhe te regjistrimit te saj.

3.Perjashtime nga taksat me ligje te tjera te veçanta.

3.1. Invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbërit, invalidët paraplegjike dhe tetraplegjike që e fitojne këtë status në bazë te ligjeve perkatese, përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta.

3.2. Në kuptimin e përjashtimit nga taksat e drejtpërdrejta, konsiderohen taksa të drejtpërdrejta taksat e mëposhtme:

a. Taksa për shërbimet konsullore.

b. Taksa për përdorimin e aparateve radiotelevizive.

c. Taksa për përdorimin e numrit telefonik kabllor.

d. Taksa për regjistrimin në arësimin e lartë.

e. Taksa për kalimin e kufirit të Republikës së Shqipërisë me avion.

f. Taksa për pajisjen me pasaportë lundrimi.

g. Taksa për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti.

h. Taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve

3.3. Përjashtimet nga taksat e drejtpërdrejta

a. Taksa për shërbimet konsullore. Përjashtimi nga taksa për shërbimet konsullore bëhet në rastet e pajisjes së veteranit të punës apo të luftës, invalidit të punës, të verbërve, të sëmurëve paraplegjike dhe tetraplegjikë me pasaportë.

b. Taksa për përdorimin e aparateve radiotelevizive. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës dhe të luftës, veteranët e luftës, personat e verbër si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, kur këto pajisje janë në emrin e tyre.

c. Taksa për përdorimin e numrit telefonik kabllor. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës dhe të luftës, veteranët e luftës, personat e verbër si dhe të sëmurët paraplegjikë e tetraplegjikë, kur abonimi telefonik është në emrin e tyre.

d. Taksa për regjistrimin në arsimin e lartë. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës dhe të luftës, veteranët e luftës, personat e verbër si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, kur dëshirojnë të vazhdojnë arsimin e lartë.

e. Taksa e kalimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë me avion. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës dhe të luftës, veteranët e luftës, personat e verbër si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, kur kalojnë kufirin e Republikës së Shqipërisë me avion.

f. Taksa për pajisjen me pasaportë lundrimi. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës apo të luftës, veteranët e luftës personat e verbër, si dhe te sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, në rastet e pajisjes me pasaportë lundrimi.

g. Taksa për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës apo të luftës, veteranët e luftës , personat e verbër, si dhe të sëmuret paraplegjikë dhe tetraplegjikë, në rastet e pajisjes me dëshmi aftësie për drejtim automjeti.

h. Taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve. Përjashtohen nga pagesa e taksës së qarkullimit vjetor të mjeteve ciklomotoret, motomjetet si dhe automjetet (4+1) në pronesi të veteranëve dhe invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, të invalidëve të punës, si dhe të të verbërve dhe të sëmurëve paraplegjike dhe tetraplegjike, kur automjeti është në zotërimin e tyre dhe përdoret vetëm për nevojat e tyre personale dhe jo për aktivitet privat.

3.4. Sipas nenit 16/1 të ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", si dhe të nenit 4 të ligjit 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", kur invalidi i punës dhe personi i verbër ushtrojnë veprimtari private, nuk përjashtohen nga taksat e dretpërdrejta.

3.5. Përjashtimi nga pagimi i taksave të mësipërme bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të veteranit të luftës, invalidit të punës a të luftës, të verbërit sëmurëve paraplegjike dhe tetraplegjike.

3.6. Veterani i luftës, invalidi i luftës apo i punës, personat e verbër si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të paraqesin pranë agjentit tatimor, librezen përkatëse së bashku me dokumentin e identifikimit të personit që përfiton përjashtimin nga taksa.

3.7. Të gjitha përjashtimet do të shënohen në një regjistër të veçantë ku do të jetë shënuar

emri, mbemri, si dhe ekstremet e librezës sipas formularit Nr.8, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4.Zbatimi i udhëzimit

Ngarkohet me zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, degët e saj dhe agjentët përkatës tatimor.

5.Shfuqizime

Udhëzimi Nr.3, datë 18.01.2005 "Për sistemin e taksave ne Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar", shfuqizohet.

6.Hyrja ne fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në fletoren zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Formulari Nr.1

Aktrakordimi mujor i takses së _____Per muajin_____

NE MIJE LEKE

Lloji i takses	Shuma e taksave te arketuara	Shuma e taksave te derdhura ne llogarine e tatimeve	Diferenca e pageses (+ose -)	Komisioni i agjentit tatimor

Dega e Tatimeve Agjenti Tatimor

Formulari Nr.2

REGJISTRI DITOR I TAKSES VJETORE TE QARKULLIMIT RRUGOR
PER VITIN Muaji_____

Nr.	Numri i		Data	Emri, mbiemri i pronarit	Targa	Lloji i mjetit	Tonazhi ose Nr.vend.	Vlera e takses (ne leke)	Numri i grupimit te mjetit (sipas fatures)
	Fatures	M.arket							

Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor

Formulari Nr.3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Financave
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Dega e Doganës

Nr. Serise data :_____

Pjesa e Pare

Emri i shtetasit_____

Adresa: Qyteti, shteti_____

Numri i dokumentit te identifikimit_____

Tipi i mjetit _____

Targa e mjetit_____

Data e hyrjes _____
(me numra dhe me fjale

Doganieri
(emer, mbiemer,firma)

Kryetari i Doganes
(emer, mbiemer, firma)

Pjesa e Dyte Data_____

Data e daljes _____
(me numra dhe me fjale

Ditet e qendrimit gjithsej _____
Në shifra dhe me fjale

Shuma e takses _____
Në shifra dhe me fjale

Taksa e llogaritet në dalje te mjetit ose në momentin e çdoganimit te mjetit kur mjeti pajiset me targa shqiptare.

Doganieri
(emer,mbiemer,firma)

Kryetari i Deges se Doganes
(emer,mbiemer,firma)

Pjesa e pare plotesohet nga dogana hyrëse dhe pritet në dy kopje njëra i jepet shtetasit, tjetra mbetet në doganë.

Pjesa e dyte plotesohet vetem në kopjen e shtetasit në doganen qe del mjeti ose ku behet çdoganimi i mjetit në rastet kur mjeti pajiset me targa shqiptare dhe dorezohet në kete dege te doganes.

Formulari Nr.4

RREGJISTRI DITOR I TAKSES SE QARKULLIMIT TE AUTOMJETEVE TE HUAJA

Nr.	Lloji i mjeteve	Emri i zoteruesit te mjetit	Shteti nga vjen mjeti	Data e hyrjes se mjetit ne doganen shqiptare	Masa e takses	Shuma e taksave te paguara

Dega e doganes

Formulari Nr.5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Financave
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Dega e Doganës

Nr.serial .....

V Ë R T E T I M

Vërtetojmë se z._____banues në qytetin _____Shteti_____ me numër pasaporte____ ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë sot më datën _____ me automjetin tip _____me targë_____. Mbi bazën e shkresës Nr.___ datë____ të degës së tatimeve ky mjet përjashtohet nga pagimi i taksës se qarkullimit të automjeteve të huaja.

KRYETARI
_____

Formulari Nr.6

REGJISTRI DITOR I TAKSES SE IMPORTIMIT TE AUTOMJETEVE
TE PERDORURA

Nr.	Emri i zoteruesit te mjetit	Lloji i mjeteve	Viti i prodhimit te mjetit	Lloji i karburantit	Masa e takses	Shuma e taksave te paguara

Dega e doganes

Formulari Nr.7

REGJISTRI DITOR I TAKSES SE PAJISJES ME LEJE DREJTIMI
PER DREJTIM AUTOMJETI

Nr.	Emer mbiemer	Lloji i lejes se drejtimit	Masa e takses	Nr.mandat arketimit

Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor

Formulari Nr.8

REGJISTRI I PERJASHTIMEVE NGA PAGESAT E TAKSAVE

Nr rendor	Emri i taksapaguesit	Statusi ligjor i perjashtimit	Lloji i takses	Vlera e takses

Agjenti tatimor

Formulari Nr.9

Akt rakordimi i takses se rentes minerare per muajin_____

Subjekti_____

Lloji i mineralit	Sasia e prodhuar	Sasia e shitur	Subjekti bleres adresa	Taksa e paguar

Data _____

Administratori
(Emer Mbiemer)

Formulari Nr.10

DEKLARIMI I TAKSES SE AMBALAZHEVE PLASTIKE
Shoqeria_____

D E K L A R A T E

Per muajin_____

Nr	Lloji i ambalazhit sipas volumit	Sasia ne cope	Taksa per njesi	Detyrimi i pageses se takses	Derdhur ne tatime
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
etj					
Shuma					

Administratori